



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 185/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur lidhur me ankesat e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partia Socialdemokrate (PSD), dhe kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të vendosjes së posterit në objekt publik në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 06 tetor 2019, në seancën e mbajtur me 04.10.2019, mori këtë:

VENDIM

KONSTATOHEN të tërhequra ankesat Anr.185/2019 e datës 02.10.2019, Anr.211/2019 e datës 03.10.2019 dhe Anr.212/2019 e datës 03.10.2019, të parashtruara nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Arsyetim

Me datën 02.10.2019, PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.185/2019 nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) kundër koalicionit AAK&PSD, me datën 03.10.2019, e njehta ka dorzuar, ankesën Anr.211/2019 kundër subjektit politik PDK dhe ankesën Anr.212/2019 kundër koalicionit AAK&PSD, të gjitha për shkak të vendosjes së posterit në objekt publik.

Me datë 04.10.2019, ankuesi ka parashtruar parashtresën për tërheqjen e ankesave Anr.185/2019 e datës 02.10.2019, Anr.211/2019 e datës 03.10.2019 dhe Anr.212/2019 e datës 03.10.2019, pa ndonjë arsyetim shtesë nga ana e tyre.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e apelit, në kuptim të nenit 11 paragrafi 2 të Rregullën Nr.02/2015 të PZAP-it si dhe nenit 115.1 të LZP -së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.185/2019 më datën 04.10.2019.

Kryesues i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.